

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 2655 Rep.
Nr. 305/3 Kol.



V E N D I M
PER LESHIMIN E DESHMISE SE TRASHEGIMISE LIGJORE

Sot, me date 18 Qershor 2014 (dymije e katermbedhjete), ditën e Merkre ora 12 une Noterja **Ermira M. RIZAJ**, anetare e Dhomes se Noterise Tirane, me Seli ne adresen Rruga "Kont Urani" Nr. 51, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga

KERKUESE:

Irena BENUSSI (SHAHINI), atesia Niko, amesia Vitore, lindur ne Tirane, me 08.06.1960, banuese ne Tirane Rruga "Don Bosko " Pallati i Ri, me Karte Nr. Personal G 05608142 J, madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

OBJEKTI:

Leshimi i deshmise se trashegimise ligjore per trashegimlensesit Niko Tush SHAHINI dhe Vitore Ndoc SHAHINI.

BAZA LIGJORE. Nenet 316 e vijues te Kodit Civil. Te vitit 1994 (i ndryshuar) Neni 53 dhe 53/1 e vijues te Ligjit Nr. 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine" (i Ndyshuar)

Une Noterja , pasi studiova dhe mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentacionin e paraqitur nga kerkuesi Irena BENUSSI (SHAHINI) .

K O N S T A T O V A S E :

Kerkuesja **Znj. Irena BENUSSI (SHAHINI)**, legjitimohet ne paraqitjen e kerkeses per shkak se eshte ne cilesine e trashegimtares ligjore te trashgimlensesve.
Gjithashtu, konstatova se kerkesa e paraqitur ploteson kushtet e nenit 348 te Kodit Civil qe eshte ne kompetencen time vendore si notere, fakt i cili vertetohet nepermjet certifikatat e vdekjes se trashegimlensesve leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Tirane .
Nga verifikimet e bera ne baze te Ligjit "Per Noterine" (i ndryshuar) rezulton se trashegimlensesit Niko Tush SHAHINI dhe Vitore Ndoc SHAHINI **nuk kane lene testament per pasoje nuk kemi te bejme me legun dhe as me barren** dhe se deshmia e trashegimise ligjore per te ndjerin Niko Tush SHAHINI dhe Vitore Ndoc SHAHINI **nuk eshte leshuar nga ndonje noter tjeter.**

Sic rezulton nga Certifikata e Vdekjes date 30.05.2014, leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njesia Bashkiake Nr. 11 Tirane, vertetohet se me date 03.09.1995, ka vdekur i ndjeri **Niko SHAHINI** , atesia Tush, amesia Gjyle, lindur ne Karagjoz Prizren, me 12.06.1920, mashkull, i martuar, shtetas shqiptar..

Sic rezulton nga Certifikata e Vdekjes Nr. 004589696 date 10.04.2014, leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njesia Bashkiake Nr.5 Tirane, vertetohet se me date 23.06.2013, ka vdekur e ndjera **Vitore SHAHINI**, atesia Ndoc, amesia Lezina, lindur ne Tirane, me 02.01.1931, me Nr. Personal D 15102067 J femer, e ve, shtetase shqiptare.

Ne baze te nenit 318 te Kodit Civil te vitit 1994, trashegimia celet ne kohen dhe ne vendin ku trashegimlensesit kane patur banimin e tyre te fundit dhe meqenese te ndjeret kane banuar ne Tirane, per leshimin e Deshmise se Trashegimise Ligjore eshte Zyra e Noterise Tirane dhe ligji i zbatueshem per leshimin e kesaj deshmie trashegimie ligjore eshte Kodi Civil date 01.11.1994 (i ndryshuar)

Sipas certifikates se Gjendjes Familjare te vitit 1950-1974, Nr. 004872496 date 11.04.2014 leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Bashkia Tirane, vertetohet se trashegimlensesi Niko SHAHINI ka qene i martuar me Vitore SHAHINI dhe nga martesja kane patur 2 (dy) femije **Ferdinand SHAHINI dhe Irena BENUSSI (SHAHINI)**, pra kane lene trashegimtare ligjore te radhes se pare 2 femijet e tyre qe jane:

1. Djalin Ferdinand SHAHINI, atesia Niko, amesia Vitore, lindur ne Tirane, me 28.12.1954, banues ne Tiranë, Rruga "Bajram Curri", shtetas shqiptar, mashkull, i martuar, me Nr.Personal F 41228053 J, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

2. Vajzen Irena BENUSSI (SHAHINI), atesia Niko, amesia Vitore, lindur ne Tirane, me 08.06.1960, banuese ne Tirane Rruga "Don Bosko" pallati i Ri, shtetase shqiptare, femer, e martuar, me Nr.Personal G 05608142 J, madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

Sa me siper vertetohet nga certifikatat e vdekjes te trashegimlensesve, certifikata e trungut familjar dhe certifikatat personale te trashegimtareve.

Nga verifikimet nuk rezulton qe ndonje nga trashegimtarete te kete hequr dore nga trashegimi, te jene shpallur te padenje per te trashguar me Vendim Gjykate, apo te jete perjashtuar nga trashegimia e trashegimlensesve.

Gjithashtu nuk u vertetua qe ndonjeri nga trashegimlensesit te kete patur femije te tjere nga ndonje martesje tjeter, te kete femije jashte martesje apo te biresuar.

PER KETO ARESYE:

Ne baze te nenit 348 te Kodit Civil nenit 126, e 391 te Kodit te Procedures Civile nenin 53 te Ligjit Nr. 7829 date 01.06.1994 (i ndryshuar) dhe Ligjit Nr. 131 date 29.04.2013.

VENDOSA:

Pranimin e kerkeses te Znj. Irena BENUSSI (SHAHINI)

Leshimin e deshmise se trashegimise ligjore per trashegimlensesit **Niko Tush SHAHINI** dhe

Vitore Ndoc SHAHINI duke percaktuar si trashegimtare ligjore te radhes se pare 2 femijet e tyre

1. **Ferdinand SHAHINI** i biri

2. **Irena BENUSSI (SHAHINI)** e bija

Te cilet trashegojne nga 1/2 pjese te barabarte sejcili te te gjitha pasurise te trashegimlensesve

kudo qe do te ndodhet dhe do te pergjigjen per te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kjo trashegimi.

U leshua ne Tirane, me 18 Qershor 2014.

NOTERIE
ERMIRA M. RIZAJ

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ANDI F. RIZAJ**

**DATE 15/07/2021
NR REP 3452**



V2021053310291455803



VËRTETIM NJËSIE ME ORIGINALIN

Sot, më datë 15/07/2021, para meje Noterit ANDI F. RIZAJ, Anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.10, KONT URANI, NR.51, u paraqit personalisht:

KËRKUES/IT:

Irena Benussi, atësia Niko, amësia Vitore, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Don Bosko; Nd. 94; H. 11; Ap. 14; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 08/06/1960, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034443042 dhe nr. personal G05608142], .

Vendim Per Leshimin e Dëshmise Se Trashegimise Ligjore e Noterise Tirane Nr.2655 rep. nr. 305/3 Kol. date 18 Qershor 2014.

Unë Noteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezultoi se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noterit, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

ANDI F. RIZAJ